



Teknologjitë digjitale në bujqësi një mundësi efikase për të reduktuar kontributin e bujqësisë në ndryshimet klimatike

Faqe 10



Regjistrimi i mjeteve bujqësore, Rama: Procedura të lehtësuara pranë vendbanimit

Faqe 5



BB, 65 milionë euro për bujqësinë: Investime në ujitje-kullim, ndërtimin e tregjeve e deri tek inovacioni

Faqe 4



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit korrik 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 466
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

BASHKIMI EUROPIAN PËR BUJQËSINË NË SHQIPËRI

AMBASADORJA E BE-SË NË TIRANË CHRISTIANE HOHMANN VLERËSON POZITIVISHT PROGRAMIN IPARD II NË SHQIPËRI

Gjatë takimit në Tiranë në kremtimin e partneritetit të fortë BE - Shqipëri, Hohmann tha:

“Zgjodhëm agroturizmin “BONUM” të shikoni se si janë përdorur fondet e BE-së në Shqipëri.

Askush nuk mund të më thotë se fondet e BE-së nuk janë përdorur fiks siç duhet”

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Grupit Teknik Kombëtar Shqiptar për GlobalG.A.P, ekspertizë në industri për certifikime dhe standarde, në përmirësimin e sigurisë së ushqimit, mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen socio-ekonomike në bujqësi

GlobalG.AP është një standard sfidues për fermerët, grumbulluesit dhe eksportuesit e produkteve bujqësore



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



Krifca: Programi IPARD vazhdon, jemi në bashkëpunim të plotë me BE-në për të përmirësuar standardet



Faqe 2

GRATË NË SIPËRMARRJE



Albana Muçaj sipërmarrëse e Qendrës Multifunkionale “Kallz”, modeli i biznesit që kontribuon në përparimin social-ekonomik të shoqërisë

Faqe 7

KËNDI I EKSPERTIT

■ Ndikimi i aditivëve enzimë në silazhet pranverore Fq.11

■ Këshilla për fermerët kultivues të perimeve Fq.11

■ Molla - Këshilla për fermerët Fq.12

■ Kalendari bujqësor, muaji gusht 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

STANDARDE

Integrimi, diskutohen zhvillimet për sigurinë ushqimore sipas BE-së



Faqe 5

ARSIM

Mbështetje financiare, Krifca fton studentët të zgjedhin degët e Universitetit Bujqësor

Faqe 4

Grupit Teknik Kombëtar Shqiptar për GlobalG.A.P, ekspertizë në industri për certifikime dhe standarde, në përmirësimin e sigurisë së ushqimit, mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen socio-ekonomike në bujqësi

GlobalG.A.P është një standard sfidues për fermerët, grumbulluesit dhe eksportuesit e produkteve bujqësore

Grupi Teknik Kombëtar Shqiptar për GlobalG.A.P mbështet me njohuri të çmuara aktorët e sektorit, me ekspertizë të thelluar dhe informacione, duke theksuar përfitimet e certifikimeve dhe standardeve sociale, ku përfshihet dhe rëndësia e GlobalG.A.P. Me vite përvoja, anëtarët e Grupit Teknik Kombëtar Shqiptar për GlobalG.A.P. shquhen si një burim ekspertizë në industri, duke dëshmuar njohuritë e tyre të thella rreth praktikave të qëndrueshme dhe standardeve.

Dy nga ekspertet e Grupit Teknik Kombëtar Shqiptar për GlobalG.A.P., tregojnë rolin kryesor që këto certifikime dhe standarde luajnë në përmirësimin e sigurisë së ushqimit, mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e përpërimit socio-ekonomik në bujqësi.

Këto praktika sjellin përfitime jo vetëm për fermerët dhe eksportuesit, por edhe për konsumatorët.

Irjana Gjana Bio Inspecta

Për certifikimin sipas standardit GlobalGAP kemi filluar me vonesë, por kemi ecur me ritme të shpejta, si edhe me aktivitete të ndryshme të cilat ndihmojnë këtë sektor. Sot janë rreth 500 Ha të mbjella në serra të certifikuar dhe mbi

2021 dhe ka anëtarë grupe të ndryshme interesi, me qëllim për të marrë sa më shumë pikëpamje që mund t'i shërbejnë këtij standardi. Qëllimi parësor është zhvillimi i udhëzuesve kombëtarë që do ta bëjnë këtë standard më të lehtë për t'u zhvilluar dhe më praktik për fermerët. Zbatimi ka sfida të shumta, prandaj ky grup pune do të ndihmojë në interpretimin e rregullores së GlobalGAP. Në pak kohë kemi arritur që të certifikojmë modulën

shkuar drejt qëllimit të unifikimit të standardit dhe pasjes së një shtylle kryesore, për të unifikuar kostot dhe kontrolluar produktet që vinin nga vendet e tjera drejt Europës.

Fillimisht ky standard u njoh si Euro - Gap dhe pastaj për të vijuar dhe shtrirë më gjerë dhe krijimin e standardit GlobalGAP. Në Shqipëri është njohur vitet e fundit dhe të gjitha kompanitë të cilat janë certifikuar e kanë si kërkesë vit pas viti që ta mbajnë këtë standard, i cili shërben si patënt për eksportin e produkteve tona drejt vendeve të Evropës dhe më gjerë. Kemi



150 fermerë të certifikuar për kultivimin e fruta-perimeve sipas këtij standardi, i cili është i domosdoshëm. Kemi module specifike për çështje të ndryshme, për mënyrën se si punonjësit trajtohen në fermë, kodin e punës, trajtimin apo shfrytëzimin e burimeve natyrore, si edhe qëndrueshmërinë e mjedisit, pasi ajo që ne i japim mjedisit është ajo që na kthehet mbrapsht.

për mënyrën e trajtimit të punonjësve dhe sot janë 74 fermerë të cilët kanë arritur të marrin këtë certifikim shtesë. Gjithmonë do të kemi module të ndryshme që do t'i shërbejnë këtij standardi dhe ne do duhet t'u përgjigjemi në kohë.

**Edita Dibra
FOTON sh.p.k.**
Cilat janë përfitimet e standardit GlobalGAP?

Përsa i përket kërkesave të standardit, si fillim kanë nisur në vendet e Evropës, bazuar në kërkesat e konsumatorëve, eksportuesve, rrjeteve të supermarketeve të mëdha, për të

kërkesa nga eksportuesit vendas, gjithashtu edhe për trajnimin e fermerëve drejt kërkesave të këtij standardi. Janë të dosmosdoshme 230 kriteret që duhet të plotësohen për certifikimin GlobalGAP, po jo të pamundura të arrihen. Ndër to përmendim monitorimin e pesticideve të përdorura për produktet, analizat e ujit dhe të tokës, investimet që fermerët duhet të realizojnë në fermë, informacioni i shtuar, etj.



Krifca: Programi IPARD vazhdon, jemi në bashkëpunim të plotë me BE-në për të përmirësuar standardet

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, duke marrë fjalë nga foltorja e Kuvendit, deklaroi se, "Programi IPARD vazhdon dhe ne jemi në bashkëpunim të plotë me BE-në, për të përmirësuar standardet".

Krifca hodhi poshtë akuzat që kanë qarkulluar në medie se, fondet e BE janë ndërprerë, duke theksuar se nuk bëhet fjalë për hetime që lidhen me korrupsion në AZHBR.

"Lajmi i vetëm ka qenë njoftimi për pezullimin e pagesës së radhës, si një masë e përkohshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë në Bruksel. Në atë letër nuk përmendet fjala korrupsion. Në këtë pikëpamje unë nuk mund të komentoj dhe as nuk mund të parashikoj asgjë nga këto rrethana", tha Krifca.

Ministrja thekson se nuk është shkelur në asnjë moment ligji dhe procedurat që po kryhen janë standarde.

"Mund t'ju siguroj që sistemi i menaxhimit të fondeve dhe procedura e ndjekur nga Agjencia janë pikërisht ato që janë të akredituara nga BE. Nëse këto procedura të verifikuara nga jashtë brenda, janë cenuar apo për shkak të zhvillimeve të ndryshme imponojnë përmirësimin e tyre, jemi të interesuar për të bashkëpunuar bashkë me OLAF, për të bashkëpunuar menjëherë dhe për të korrigjuar veprimtarinë e institucionit. Programi nuk është ndalur, ai është në funksion", deklaroi Krifca.

Sipas saj, çdo fjalë u përdor nga opozita për këtë çështje ishte me qëllimin e vetëm për t'i vënë flakën gjithçkaje të mirë të ngritur me mund e me pasion nga njerëz që e duan zhvillimin e këtij vendi.

Duke iu drejtuar publikut, komunitetit rural, ministrja tha se, "dje nuk ka pasur një lajm të ri – lajmi se AZHBR është vënë nën hetim administrativ, nga Struktura e Bashkimit Europian për Paranadalinin e Mashtrimit – OLAF, është një lajm i bërë publik në media prej kohësh, prej shkurtit të vitit 2021, kur kemi patur kontroll. Lajmi i vetëm ka qenë njoftimi për pezullimin e pagesës së radhës, si një masë preventive e përkohshme dhe e ndërmjetme që Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë së Komisionit ka marrë, me qëllim sqarimin e rrethanave në lidhje me sistemin e kontrollit dhe parandalimin e mashtrimit nga faktorë të brendshëm e të jashtëm".

"Në këtë pikëpamje unë nuk mund të komentoj dhe as mund të parashikoj asnjë nga këto rrethana, por mund t'ju siguroj se sistemi i menaxhimit të fondeve dhe procedurave për-

katëse të ndjekura nga AZHBR janë pikërisht ato të cilat janë miratuar nga strukturat e Bashkimit Europian dhe janë zbatuar nga institucionet tona. Nëse këto procedura të verifikuara

det anëtare të Bashkimit Europian, vetëm në dy prej tyre nuk janë gjetur parregullsi në përdorimin e fondeve. Gjermania, Franca, Italia, Spanja, Holanda, Belgjika janë vetëm disa



nga kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm janë cenuar apo për shkak të zhvillimeve shoqërore, ekonomike, teknologjike imponohen përmirësime të këtyre procedurave të miratuara nga vetë BE, ne jemi të interesuar dhe bashkëpunues për t'i zbatuar ato menjëherë dhe për të korrigjuar veprimtarinë e institucionit", u shpreh ministrja.

Krifca deklaroi se programi nuk është ndalur, ai vijon. Autoritetet zbatuese janë në punë dhe në partneritet të plotë me strukturat e Bashkimit Europian për të siguruar plotësimin e çdo kërkesë apo kushti dhe mbarëvajtjen e plotë.

"Zbatimi i këtij programi përmes strukturave të akredituara kërkon përmirësime të vazhdueshme për t'u përballur me sfidat e bujqësisë, një sektor që edhe pse ka bërë përparime të mëdha, ka ende informalitet. Por, është jetike dhe e rëndësishme për vendin, që një program i pazëvendësueshëm, i cili ka dhënë impakt të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë rurale, duke çuar financim në çdo cep të saj, në zonat më të thella, një sukses i padiskutueshëm i sektorit, të mos bëhet objekt i konsumit politik të ditës, pa llogaritur pasojat. Është e nevojshme të sqarohet publikun dhe mbi natyrën e hetimit administrativ që kryhet nga OLAF – arma e kontrollit financiar e Bashkimit Europian për parandalimin e mashtrimit – e cila ka në fokus të veprimtarisë së vet të gjitha institucionet që menaxhojnë fonde të Komisionit, ashtu sikurse bën edhe AZHBR", tha ministrja, teksa vuri në dukje se, "kjo zyrë vihet në lëvizje në momentin e denoncimit nga kushdo qytetar mbi arsye të besueshme për parregullsi të caktuara apo mashtrim".

Ministrja solli në vëmendje se, nëse i referohemi raportit 4-vjeçar të OLAF për periudhën 2016-2020, nga të 27 ven-

nga vendet e BE ku janë gjetur problematika të ndryshme të mashtrimit dhe secila nga këto vende është detyruar të rimbursojë fondet europiane.

"Çdo parregullsi hetohet dhe çdo fond i përfutur në mënyrë të parregullt rimbursohet. Kjo nuk do të thotë që në këto vende ka korrupsion, por do të thotë që kudo, si në Gjermani, por aq më shumë në Shqipëri, ka vend për përmirësim", tha ministrja.

Ajo theksoi se, prej momentit të parë të vënies në dizenj të hetimit të OLAF, AZHBR si strukturë e akredituar nga Bashkimi Europian, me një standard të lartë transparence dhe gjurmueshmërie i ka vendosur në dispozicion kësaj zyre të gjithë bashkëpunimin e saj, duke bërë disponibël çdo shkresë, çdo dokument, çdo informacion të mundshëm, për të nxjerrë në dritë pretendime për shkelje të dyshuara.

Ministrja informoi se ky hetim administrativ i OLAF, i kryer prej tre viteve, nuk ka prodhuar deri më sot asnjë raport të gjetjeve, ndërkohë që deklarata e Komisionit Europian ka qenë lidhur me denoncime të bëra pranë kësaj strukture për dyshime korrupsioni. Nuk thuhet në asnjë moment se ka korrupsion apo jo.

"Ne nuk pretendojmë të jemi perfektë. Konstatimet dhe rekomandimet i shohim si mundësi për të ndërtuar procese më të forta dhe transparente. Madje në cilësinë e Ministrit të Bujqësisë, jam më shumë se kushdo e vëmendshme që çdo rekomandim apo nevojë për korrigjim ta zbatojmë për të përmirësuar proceset administrative dhe punën e agjencisë për të krijuar më shumë zhvillim. Për sa më përket mua personalisht, si ish-titullare e institucionit,

(Vijon në faqen 4)

AGROTURIZËM

Krifca në samitin e OKB në Romë: Rezultate mbresëlënëse nga lidhja e bujqësisë me turizmin

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, njëherazi presidente e Institutit për Studime të Avancuara Agronomike të Mesdheut (CIHEAM) me ftesë të homologut italian Francesco Lollobrigida, po merr pjesë në panelin e nivelit të lartë të sistemeve ushqimore të Kombeve të Bashkuara zhvilluar ditën e sotme në Romë, Itali.

Objektivi i samitit është të ofrojë modele drejt ndërtimit të sistemeve ushqimore më efikase, më gjithëpërfshirëse, më të forta dhe më të qëndrueshme.

Diskutimet u përqendruan dhe tek dieta mesdhetare, si një mënyrë e të ushqyerit, e cila lidhet fort me kulturën e traditat e vendeve mesdhetare, ku Shqipëria si një prej tyre, është kthyer në eksportues të rëndësishëm rajonal dhe evropian për frutat dhe perimet e freskëta, vajit të ullirit, bimëve mjekësore dhe peshkimit duke konkurruar me cilësi të lartë për shkak të forcimit të zinxhirit të vlerës.

Krifca, në fjalën e mbajtur në këtë samit të rëndësishëm, vuri theksin tek sfidat serioze me të cilat po përballen sistemet dhe tregjet ushqimore në të gjithë botën.

Ministria theksoi se arritja e objektivave ushqimore të zhvillimit të qëndrueshëm të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara arrihen më shpejt me anë të adoptimit të politikave mesdhetare të prodhimit.

“COVID-19, luhajtje të tregut, ndryshime ekstreme klimatike, konflikte luftarë. Në vitin 2023, përsëri jemi dëshmitarë të përdorimit të ushqimit për të negociuar politikisht. Tani është më shumë se kurrë është e domosdoshme për të përshpejtuar veprimet për arritjen e SDG-ve deri në vitin 2030. Dhe mundësitë janë pikërisht këtu!”, tha Krifca.

“Hulumtimet e vazhdueshme tregojnë se respektimi i një diete mesdhetare ofron përfitime shëndetësore, por gjithashtu promovon prodhimin dhe të ardhurat e qëndrueshme, mbron biodiversitetin e pasur, përmirëson ndërveprimet



njerëzore – ndërsa ushqimet zbulohen, ndahen dhe shijohen përmes lidhjes së njerëzve, që mbron shëndetin individual dhe kolektiv, respekton natyrën, i jep vlerë traditave lokale dhe promovon zhvillimin e biznesit, diversitetin, barazinë sociale dhe prosperitetin”, tha ministria e Bujqësisë.

Në lidhje me përballimin e këtyre sfidave nga Shqipëria, ministria Krifca risolli në vëmendjen e kreu të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ministrave të bujqësisë nga vende të ndryshme të botës, modelin e zhvillimit bujqësor që po zhvillohet në Shqipëri.

“Në Shqipëri kemi provuar shumë zgjidhje, por ajo që jep rezultate mbresëlënëse është një model i bazuar në diversifikimin e aktiviteteve në nivel fermeri, që lidh bujqësinë me turizmin, duke rritur bukurinë e territoreve tona, duke nxitur një lidhje më të fortë me

muniteteve, kulturës dhe historisë”, shtoi ajo.

“Kjo dhe shumë më tepër e bëjnë dietën mesdhetare një shembull të një oferte tradicionale

rrënjët për të rinjtë tanë. Ky model mbështetet në forcimin dhe zgjerimin e njohurive në nivel fermeri dhe integrimin në mënyrë të vazhdueshme të inovacionit për të mundësuar produkte cilësishme më të mira dhe me vlerë të shtuar më të lartë”, tha Krifca.

“Kjo është ajo që e ka bërë Shqipërinë eksportues të rëndësishëm rajonal dhe evropian të frutave dhe perimeve të freskëta, vajit të ullirit, bimëve mjekësore dhe peshkimit”, përfundoi Krifca.

Në samit marrin pjesë kreu i Organizatës Botërore të Ushqimit, Qu Dongyn, kreu i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ministri italian i Bujqësisë, Francesco Lollobrigida, ministri japonez i Bujqësisë, Katsumata Takaaki. Kreu i organizatës më të madhe të fermerëve në Italia Coldiretti, Ettore Prandini e shumë aktorë të tjerë botërorë të rëndësishëm për forcimin e prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm.

Turizmi rural në zhvillim, “Oda e Hasanbeut” në Mullet, një tjetër bujtinë me mbështetjen e AZHBR

Qytetarët e Tiranës dhe turistët e huaj, që tashmë kanë vërshuar në këtë sezon veror, kanë një tjetër stacion ku mund të kalojnë fundjavat dhe pushimet e tyre.

Në Mullet të Tiranës mes natyrës së mrekullueshme ndodhet “Oda e Hasanbeut”, një tjetër sipërmarrje e mbështetur nga AZHBR, në kuadër të zhvillimit të turizmit rural.

“Oda e Hasanbeut” nisi fillimisht si një restorant në Tepele-në, e më pas u kthye në bujtinë në periferi të kryeqytetit, falë mbështetjes së qeverisë përmes AZHBR. Mes pamjes panoramike të fshatit, aty gjen ambiente çlodhëse dhe argëtimi, për fëmijë dhe të rritur, si edhe mund të shijohen gatimet më të mira dhe autentike shqiptare.

Zhvillimi i sipërmarrjeve agroturistike është shndërruar në një format të suksesshëm të investimeve në sajë të programit IPARD II, të cilat kanë

sjellë zhvillim dhe të ardhura të qëndrueshme në zonat rurale.

AZHBR bën të ditur se, vitin e fundit ka një interes të

sishmit në vend për ndikimin në ekonominë lokale.

Si kombinim perfekt mes turizmit dhe bujqësisë, strategjia e



shtuar nga banorët e zonave rurale, të rinj kryesisht, por jo vetëm, për të bërë investime të tilla. Në shumë raste, modelet e agroturizmeve po konkurrojnë fort, duke e shndërruar këtë sektor nga më të rëndësishmit ka rezultuar e suksesshme, duke garantuar treg të sigurt për fermerët e zonave rurale, rritjen e ekonomisë për familjet e angazhuara në punët e brendshme, apo të zinxhirit të furnizimit në këto njësi.

agroturizmit ka rezultuar e suksesshme, duke garantuar treg të sigurt për fermerët e zonave rurale, rritjen e ekonomisë për familjet e angazhuara në punët e brendshme, apo të zinxhirit të furnizimit në këto njësi.

Eksperiencat e avancuara kineze në bujqësi, fuqizim zhvillimit rural

Teknologjitë digjitale po transformojnë bujqësinë me shpejtësi në shumë vende të botës, rrugë të cilën synon edhe zhvillimi rural në Shqipëri.



Ekspertë të bujqësisë dhe Agjencisë për Zhvillimin e Investimeve të Huaja, morën pjesë në seminarin mbi Bashkëpunimin Bujqësor dhe Menaxhimin Inovativ për Shqipërinë për vitin 2023, të organizuar nga Qendra për Bashkëpunimin Ndërkombëtar, pranë Ministrisë së Bujqësisë të Republikës Popullore të Kinës.

Gjatë seminarit, pjesëmarr-

ësit u njohën me eksperiencat e avancuara të Kinës në zhvillimin bujqësor, rëndësinë e politikave në zhvillimin e bujqësisë, si dhe teknologjitë e përdorura.

Përmes pjesëmarrjes në këtë seminar, pati mundësinë të njihet me praktikën më inovative në menaxhimin bujqësor, duke u fokusuar në rivalizimin rural, menaxhimin cilësor të produkteve bujqësore, zhvillimin e bujqësisë smart dhe mundësitë për implementimin e këtyre praktikave në sistemin bujqësor shqiptar.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bën të ditur se

nxitja e zhvillimit novator në bujqësi në kushtet e ndryshime klimatike, zë një vend të rëndësishëm në politikën e qeverisë.

“Bujqësia digjitale ndihmon fermerët të kuptojnë më mirë faktorët që ndikojnë në prodhim si uji, toka, faktorët biologjikë dhe menaxhimin më të mirë të tyre. Shumë probleme lidhur me ndryshimet klimatike si thatësirat dhe mungesa e ujit në bujqësi mund të zgjidhen nëpërmjet bujqësisë digjitale duke përdorur metoda automatizimi të ujitjes, duke reduktuar humbjet e ujit”, shprehen ekspertët.

Gjithashtu, theksojnë ata, problemet e mbrojtjes së bimëve lidhur me shfaqjen e sëmundjeve e dëmtesve të rinj në ndikimin e kushteve të reja klimatike mund të monitorohen dhe kontrollohen nëpërmjet pajisjeve digjitale.

Mbarështimi shtazor, probleme të mirëqëniessë kafshëve në kushtet e ndryshimeve klimatike dhe impaktit mjedisor të mbarështimeve mund të kontrollohen me pajisje të reja digjitale.

përpunimit ka sjellë uljen e kostos së energjisë, pasi përdoret gaz. Ndërsa linja e re që bën thyerjen e arrorëve ka mundësuar zëvendësimin e lëndës së parë nga importi me atë të fermerëve vendas, pasi tashmë i marrin frutat e thata direkt nga fermat dhe i përpunojnë në fabrikë sipas standardeve më të larta e me një kosto më të ulët.


Në Kashar, 15 km larg Tiranës, falë mbështetjes së Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), nëpërmjet Programit IPARD, është ngritur një fabrikë e re agropërpunimi, që ka sjellë një standard të ri për përpunimin e frutave të thata dhe ekonominë e zonës.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca sollti shembullin e kompanisë “Als & Co” që me mbështetjen e IPARD investojë në teknologjinë e përparuar të linjës së plotë të përpunimit dhe paketimit të frutave të thata, që ndihmon në zëvendësimin e lëndës së parë nga importi me atë të fermerëve

vendas dhe ka ulur kostot e prodhimit.

Nertila Sadedinaj, menaxhere e kompanisë tregon se, kjo sipërmarrje ka 20 vjet që operon në treg dhe nevoja për zëvendësimin e pajisjeve dhe makinerive me linja të reja ishte mëse e nevojshme, ndaj aplikuan pranë AZHBR për të marrë ndihmë nga IPARD.

“Me mbështetjen e



Mbështetje nga IPARD, për linjën përpunuese të frutave të thata, Krifca: Rrisim standardet në prodhim, fuqizojmë ekonominë fermere

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bën të ditur se

Ministria Krifca theksoi se, “politikën tona janë të orientuara qartë drejt fuqizimit të ekonomisë së fermerëve, përpunuesve dhe markës shqiptare në tregje, duke ofruar njëkohësisht cilësinë më të lartë të produktit final tek konsumatori dhe për eksport”.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

NDIKIMI I ADITIVËVE ENZIMË NË SILAZHET PRANVERORE

Silazhimi është një metodë mikrobiologjike dhe kimike shumë efikase që përdoret për përpunimin dhe konservimin e ushqimeve të njoma foragjere që mbështetet në parimet e ceno-anabiozës dhe acidoanabiozës, ku në bazë të saj qëndron veprimtaria e mikroflorës laktike e cila bën zbrërthimin e sheqerëve të masës bimore në acide organike me mbizotërimin e acidit laktik, duke krijuar një mjedis me aciditet të theksuar (pH jo më i lartë se 4.0–4.2) në të cilin frenohet zhvillimi i bakterieve të padëshirueshme duke ruajtur në këtë mënyrë silazhin nga prishja.

Shtimi i enzimave në silazhe ka marrë vëmendje të konsiderueshme gjatë dekadës së fundit. Funkzioni i tyre kryesor është të zbrërthojnë fibrat në foragjere gjatë fermentimit, duke e bërë silazhin më të tretshëm gjatë ushqimit. Ndarja e fibrave në sheqerna të tretshëm gjithashtu ndihmon bakteret të prodhojnë acid laktik, i cili ndihmon në uljen e pH të silazhit.

Ka shumë produkte enzimë në treg për përdorim në silazhe. Ky artikull do të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e enzimave në ruajtjen e silazheve dhe rritjen e përdorimit të ushqimit në kafshët e fermës.

Aditivët e zakonshëm të silazhit me bazë enzima përmbajnë celulaza, hemicelulaza, ksilanaza, amilaza dhe pektinaza. Celulazat, hemicelulazat dhe pektinazat janë enzima që degradojnë pjesën e fibrave të foragjereve. Amilaza zbrërthojnë niseshtenë

(amilozën), prandaj përdorimi i saj do të drejtohej drejt silazheve që përmbajnë niseshte siç është silazhi i misrit.

Deri më sot, rezultatet e hulumtimit kanë qenë të përziera dhe nuk është shfaqur ndonjë prirje e qartë. Disa studime kanë demonstruar përmirësim të performancës së kafshëve (d.m.th., prodhim më të lartë të qumështit), ndërsa të tjerat nuk kanë treguar asnjë përfitim për ushqimin e silazheve të trajtuara me enzime. Një numër studimesh kanë treguar përmirësim të marrjes së lëndës së thatë kur kafshët ushqeheshin me silazhe të trajtuara me enzime.

Enzimët mund të përmirësojnë fermentimin e silazhit kur substrati (p.sh. sheqernat) është i kufizuar. Sheqernat e tretshme kërkohen për të ndihmuar bakteret të prodhojnë acid laktik, i cili kërkohet për të ulur pH-in e silazhit për fermentimin e duhur. Në përgjithësi, shtimi i enzimës në silazhe ka një efekt të vogël pozitiv në fermentim.

Është interesante se tendencat aktuale në teknologjinë e enzimave përfshijnë përfshirjen e enzimave drejtpërdrejt në racionet totale të përziera ose silazhe përpara se të ushqehen. Hulumtimet fillestare kanë vërejtur disa efekte pozitive duke përdorur këtë metodë.

Është e qartë se enzimët mund të jenë

efektive në rritjen e performancës së kafshëve. Megjithatë, përdorimi komercial i enzimave me silazhe është kufizuar nga mungesa e rezultateve të vazhdueshme pozitive në studimet kërkimore dhe kostoja e lartë e aditivëve të silazhit me bazë enzima. Më poshtë po rendisim disa avantazhe të përdorimit të aditivëve me bazë enzime.

- Aktivizimi i fermentimit të acidit laktik.
- Kombinim për rezultate dhe rendimente të larta nga formuesit e acidit laktik dhe acidit acetik.
- Ulje e menjëherëshme e Ph-it.
- Ruan lëndët ushqyese në silos (gropë) dhe në sipërfaqen e kositur.
- Kontrollon procesin për një fermentim optimal.
- Përmirëson shijen dhe siguron marrjen e plotë të ushqimit.
- Ulja e shpërbërjes së proteinave. Parandalon formimin e acideve dhe redukon humbjen e proteinave. Më shumë proteina në silazh.
- Redukton rrezikun dhe nga moti i keq.
- Tretje optimale të silazhit.
- Një stabilitet i qëndrueshëm pas hapjes.
- Ul ndjeshëm humbjet në silazh.
- Përmirësim të dukshme të stabilitetit aerob.

• Pakësim i humbjeve dhe nga frymëmarrja

• Konsum i lartë ushqimor nëpërmjet silazhit të mirë.

• Asimilim më i lartë i ushqimit.

• Përmirësim i tretjes dhe përqendrimit të energjisë.

• Humbje të pakta në sipërfaqen e gropës (silosit).

• Efekt parandalues mbi rritjen e myqeve dhe majave.

• Më shumë energji e tretshme dhe rezultate të larta nga ushqimi bazë etj.

Teknologjia e enzimave vazhdon të përmirësohet. Produktet e reja të destinuara për ripërtypësit dhe për lloje specifike të ushqimit do të rrisin potencialin për përdorim fitimprurës të enzimave me silazhet. Teknologjitë premtuese të enzimës duhet të vlerësohen nga prodhuesit rast pas rasti nga rezultatet e kërkimit të pavarur derisa të shfaqen performanca më e qartë e kafshëve dhe raportet e kostove ndaj përfitimit. Prodhuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se disa inokulantë bakteriale përmbajnë nivele të ulëta enzimesh. Shpesh këto nivele nuk janë të mjaftueshme për të krijuar efektet e dëshiruara.



Drejtorja e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

KËSHILLA PËR FERMERËT KULTIVUES TË PERIMEVE

Muaji korrik është muaji ku temperaturat kanë arritur vlerat e tyre të larta karakteristike për stinën e verës.

Problemet e fermerëve janë të shumta, por do të veçohen ato të kultivuesve të perimeve:

Në serra:

Pjesa më e madhe e serrave është duke kryer dezinfektimin termik i cili kryhet në temperatura të larta për një periudhë kohe minimalisht 45 ditë.

Një sasi e serrave vazhdon në prodhimin me specat, trangull, domate, patëllxhan për të cilët, në këto ditë me temperatura të larta dhe shumë ndriçim, do të veçonim ruajtjen e regjimit termik dhe të lagështisë ajrore, nëpërmjet ajrimit, të serrës në kohën e duhur, si dhe rregullimin e ndriçimit, duke hijezuar serrën me rrjeta hijezuese ose në mungesë të tyre, duke e sperkatur sipër me gëlqere. Duhet pasur parasysh këtu ruajtja e një niveli temperature që të sigurojë një

ndryshim jo shumë të madh midis ditës dhe natës dhe në raport të drejtë me ndriçimin, si dhe një lagështi ajrore të tillë që bimët të mos arrijnë në pikën kritike të evapotranspirimit. Një ajrim i mirë i serrës siguron qarkullimin e mirë të ajrit, polenizim të mirë të luleve dhe një numër shumë të mirë të frutave edhe në lulëritë e sipërme, sidomos në domate, spec.

Ushqimi i bimëve në këtë fazë është intensive dhe rekomandimi më i mirë do të ishte një ushqyerje me elemente në raport të balancuar, duke shoqëruar me sulfat potasi, mikroelemente. Kjo do të sigurojë një zhvillim të mirë të bimëve, një raport shumë të mirë të masës gjethore dhe numrit të luleve e frutave në bimë, por edhe fru-

ta cilësore në pjekje e me ngjyrë të bukur.

Trajtimet kimike duhet të bëhen të rregullta, sipas një grafiku të mirëpërcaktuar si për sëmundjet kërpudhore, ashtu edhe për dëmtuesit, por përherë duke pasur parasysh që spërkatjet të kombinohen mirë me ajrosjen e serrës. Trajtimet të kryhen herët në mëngjese.

Në fushë:

Edhe për kultivuesit e perimeve në fushë të hapur, këto ditë janë tepër të ngarkuara për mbjelljen (shalqi, pjepër) dhe ushqyerjen e bimëve të mbjella. Bimët në prodhimin domate, specat, patëllxhan, bamje. Kulturat që janë mbjellë duhet të plehërohen rregullisht me plehra me formula të tilla ku

elementet ushqyese të jenë të ballancuar si dhe atje ku ka zhvillime bimore në masë jo të pëlqyeshme të përdoren edhe preparate me përmbajtje aminoacide, plehërim me formula të ndryshme sipas fazave të zhvillimit të bimëve.

Trajtimet për mbrojtjen e bimëve, në fushë të hapur, janë disi më të vështira, por megjithatë nuk duhen neglizhuar dhe duhet të aplikohen sipas një kalendari të përcaktuar, duke alternuar edhe preparatet e përdorura, me qëllim që të ruhen parametrat e sigurisë ushqimore.

Tërësia e masave mbrojtëse kombinuar me trajtimet kimike, biologjike dhe mekanike ndihmojnë në mbrojtjen e bimëve.

Problem do të jetë kufizimi i dëmtuesve si tenja e domates (Tuta absoluta), krahëbardha (Ehiteflis). Ky dëmtues është polifage i pëhapur në perimet nëserra dhe në fushë është me problem për t'u kontrolluar.

Drejtorja e Teknologjive të Perimeve: QTTB-Lushnje
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

KËSHILLA PËR FERMERËT

Gjatë kësaj periudhe fermerët e frutikulturës (mollës), duhet të intensifikojnë punën e tyre për përfundimin në afat të rrallimit të frutave të mollës. Dihet që një rrallim cilësor dhe ngarkesë optimale me fruta në kurorën e bimës ndikon në rritjen e madhësisë e cilësisë së prodhimit, uljen e periodicitetit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit nga shitja e frutave me çmim më të lartë për shkak të rritjes së cilësisë dhe ruajtjes afat gjatë në frigorifer.

Gjithashtu fermerët duhet të vazhdojnë punën e tyre në mbrojtjen fitosanitare të pemëtoreve për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve tek molla. Trajtimet kimike duhet të bazohen në monitorimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në pemëtore, duke kryer trajtime në kohën e duhur, kryesisht herët në mëngjes, ose mbasdite kur temperaturat janë në rënie dhe efekti i trajtimit kimik në bimë është më i lartë. Bima e absorbon më mirë kimikatin e përdorur në trajtim dhe rrit efektivitetin e tij në mbrojtjen fitosanitare.

Nuk duhet të spërkatim në kohë me erë dhe në kohën e drekës kur temperaturat janë të larta, ku avullimi i solucionit është i menjëhershëm, duke ulur efektin e trajtimit në pemëtore dhe rritur rrezikun nga infeksione të mundshme të kromës, hirit dhe dëmtues si krimbi, merimaga, morri etj.

E rëndësishme në trajtimet kimike në këtë periudhë është mbulimi i gjithë bimës me pesticide gjatë trajtimit, pasi në të kundërt do të kemi vatra infeksioni që do të bëhen burim i përhapjes më pas në pemëtore. Gjithashtu fermerët duhet të kryejnë edhe punët e sezonit si punimet brenda rreshtave, herbicidim nën kurorën e bimës për luftimin e barërave të këqija.

Në varësi të kushteve meteorologjike dhe gjendjes së lagështisë në tokë të kryejnë ujitjen e pemtores dhe mbajtjen e lagështisë në nivelin optimal 60-70% të kapacitet uJOR fushor.

Të bëhen plehërime plotësuese me plehra kristalore nëpërmjet ujitjes dhe spërkatjes për rritjen e zhvillimit të frutave, pasi jemi në periudhën e rritjes intensive të tyre dhe bima kërkon ushqim të vazhdueshëm për zhvillim dhe diferencim të sythave frutore për vitin pasardhës.

Disa nga plehtrat kimike që duhet të përdoren në këtë periudhë nga kultivuesit e mollës janë: 30% N (Azot), 30% K₂O (Potas), Nitrat kalciumi 40% të sasisë vjetore të planifikuar, si dhe trajtime gjethore me Seniphos 10 lit/ha, me 1 ose 2 aplikime në interval

kohor 10 ditor.

Një nga dëmtuesit që mund të shfaqen tek molla në këtë periudhë dhe që nuk duhet të neglizhohet është:


Krimbi i Mollës (*Carpocapsa pomonella*)

Është dëmtuesi kryesor i pemëve frutore (mollë, dardhë, ftua etj). Ai dëmton në masë të ndjeshme prodhimin dhe përkeqëson cilësitë e frutave, duke i bërë ato të pa konsumueshme.

Insekti i rritur është flutur e familjes lepidoptera. Larva është një krimb me ngjyrë rozë, me kokë ngjyre kafe të çelur, me gjatësi 1-2 cm, që jeton brenda frytit.

Fluturat kanë trup 7-9 mm të gjatë, ngjyrë të përhimët të errët, pothuajse të njëjtë me lëvoret e degëzave dhe vështirë është të dallohet gjatë ditës.

Në krahët e përparme ka vija të murme, tërthore dhe të lakuara në formë valësh. Çdo frut ka vetëm një krimb. Pasi mbaron rritjen e saj larva futet në tokë ose në të çarat e lëvores së trungut të bimës dhe formon një mëshikëz, e cila



jep më tej fluturën e rritur.

Dimëron si larvë në frutat e prekura dhe mbeturinat e tjera të pemës. Fluturat e para shfaqen në fund të muajit Maj ose fillimi i Qershorit. Gjenerata e dytë paraqitet në mes të Korrikut dhe shfaqja e tyre vazhdon e shkallëzuar deri në Gusht-Shtator me brezninë e dytë. Pasi dalin fluturat, ato vendosin vezët mbi gjethëzat që rrethojnë frytin ose në sipërfaqen e frytit. Fluturat lëvizin natën, në kohë të qetë e të ngrohtë. Vendosja e vezëve ngadalësohet kur temperatura e ajrit është nën 15°C dhe ndërpritet plotësisht në temperaturën nën 12°C. Kur kushtet janë të mira një femër

gjatë 10-20 ditëve vendos deri 80 vezë. Inkubacioni i vezëve zgjat 8-18 ditë. Larvat sapo dalin, futen në frutat e mollës dhe aty zhvillohen për rreth 3-4 javë, pastaj nimfosen në tokë ose në vende të tjera të mbrojtura të pemës. Insekti ka 1-2-3 breznitë në vit, gjë që varet nga kushtet klimatike të motit. Larva sapo hyn në

frutë fillon të bëjë një galeri spirale duke u drejtuar në qendër të frutit. Ajo nxjerr jashtëqitjet nëpërmjet këtyre kanaleve të cilat duken me sy në hyrje të galerisë. Për të luftuar me sukses krimbin e mollës organizohet prognozimi-sinjalizimi i shfaqjes së tij për të përcaktuar afatin



Kafaz për kapjen e fluturave të krimbit të mollës me feromone

optimal të fillimit të trajtimeve.

Metodat e monitorimit të dëmtuesit

Monitorimi bëhet përmes ferrograckave dhe shumëve të temperaturave aktive ditore. Monitorimi më i mirë është me anë të grackave me feromone të cilat

bëjnë kapjen e fluturave, ku në bazë të fluturimit maksimal jepet dhe njoftimi për spërkatjen dhe luftimin në kohë të këtij dëmtuesi.

Pragu kritik

1 javë deri 10 ditë pas fluturimit, maksimal 1-2 vezë ose larva në 100 fruta.

Trajtimet (ndaj breznisë së parë) rekomandohen kur kufiri kritik arrin infeksionin 5% të frutave të prekur, ndërsa ndaj breznisë së dytë 2% të frutave të dëmtuar.

Menaxhimi i dëmtuesit dhe masat agroteknike

Zgjedhja me kujdes e vendit për ngritjen e pemtores, p.sh. jo afër pyjeve apo kopshteve, largimi i lëvores të hapura të trungut dhe degëzave, vendosja e mbështjellësve me karton rreth trungut të pemës me qëllim që insekti të vendos nimfat, i largojmë dhe i shkatërojmë ato në fund të sezonit, armiqtë natyrorë, përdorimi i kurtheve

me ndriçim, grackat-feromonet, largimi dhe asgjësimi i frutave të infektuar, krasitja e degëzave të gjata. Këto janë masa shumë efikase në zvogëlimin e numrit të krimbit të mollës.

Masat fizike dhe mekanike

Vendosja e brezave në trupa të pemëve me qëllim që të krijohen

kushtet e përshtatshme artificiale për dimërim. Në fillim të dimrit, brezat me vemje të grumbulluara largohen dhe digjen.

Masat biologjike

Masat biologjike konsistojnë në parazitët që ushqehen me vezët e krimbit të mollës (*Trichogramma*, *Ascogaster*) dhe të disa llojeve të mizave (*Ichneumonidae*, *Tachinidae*). Zogjtë janë predatorë të rëndësishëm të krimbit të mollës, gjithashtu dhe shumë specie merimangash që përfshijnë specie të merimangave, p.sh. (*Formica fusca*), dhe gërshtëza evropiane (*Forficula auricularia*). Brumbujt e tokës gjithashtu mund të ushqehen me larva të rritura.

Feromonet për çorientim të parëzimit janë një opsion për kontrollin e tyre dhe ka dhënë rezultate të mira, po ky kontroll është i kushtueshëm. Në fazën e parë mund të përdoren feromone për çorientim seksual të krimbit të mollës, të cilët duhet të vendosen pikërisht para fillimit të fluturimit të insekteve.

Lufta kimike

Gjatë vegjetacionit mund të kryhen gjithsej 3-4 trajtime me pesticide të ndryshme dhe me alternimin e tyre për rritjen e efektivitetit të trajtimeve në pemëtore. Spërkatja e parë (breznia e parë) duhet të kryhet para se larvat të depërtojnë në fruta. Për luftimin e breznisë së parë zakonisht kryhen trajtime në fund të muajit maj, fillim i muajit qershor, ndërsa trajtimi i dytë korrik-gusht.

Për luftimin e krimbit të mollës përdoren insekticide të ndryshme si: Acetamiprid (mospilan), Chlorpyrifos 48 EC, Calypso, Decis etj.

Drejtorja e Teknologjive Bujqësore: QTTB-Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

KËNDI I EKSPERTIT

Pamja e qiellit gjatë muajit Gusht 2023

Mël gusht - Hëna e plotë, Superhëna. Hëna do të jetë e vendosur përballë Tokës

Kalendari bujqësor, muaji gusht 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Zhvillimi i reve

Muaji Gusht në Tiranë do të përjetojë rritje të mbulesës së qiellit me re, ku përqindja e kohës që qielli është me

Parashikimi i motit për muajin gusht 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with 11 columns: Dt., Temperatura e ajrit °C (U, L), Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë D, N, Drejtimi D, N), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, and Simboli. It contains daily weather forecasts for Tirane from August 1st to 31st.

Parashikimi i motit për gusht 2023 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with 11 columns: Dt., Temperatura e ajrit °C (U, L), Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë D, N, Drejtimi D, N), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, and Simboli. It contains daily weather forecasts for Korca from August 1st to 31st.

nga Dielli dhe do të ndriçohet plotësisht siç shihet nga Toka. Kjo fazë do të ndodhë në orën 20:31 UTC. Kjo hënë e plotë njihet nga fiset e hershme indigjene amerikane si Hëna e Sturgeon sepse peshqit e mëdhenj të blirit të Liqeneve të Mëdha dhe liqeneve të tjerë të mëdhenj kapeshin më lehtë në këtë kohë të vitit. Kjo hënë është njohur edhe si Hëna e Gjelibër e Misrit dhe Hëna e Drithrave. Kjo është gjithashtu e dyta nga katër superhënat për vitin 2023. Hëna do të jetë afërdimit të saj më të afërt me Tokën dhe mund të duket pak më e madhe dhe më e ndritshme se zakonisht.

Më 10 gusht - Mërkuri në zgjatimin më të madh lindor. Planeti Mërkuri do të arrijë zgjatjen më të madhe lindore prej 27. 4 gradë nga Dielli. Kjo është koha më e mirë për të parë Mërkurin pasi ai do të jetë në pikën e tij më të lartë mbi horizontin në qiellin e mbrëmjes. Kërkonti planetin poshtë në qiellin perëndimor menjëherë pas perëndimit të diellit.

Më 12, 13 gusht - Dushi meteor i Perseidëve. Perseidët është një nga shirat më të mirë të meteorëve për t'u vëzhguar, duke prodhuar deri në 60 meteorë në orë në kulmin e tij. Është prodhuar nga kometa Swift-Tuttle, e cila u zbulua në vitin 1862. Perseidët janë të famshëm për prodhimin e një numri të madh meteorësh të shndritshëm. Dushi zhvillohet çdo vit nga 17 korriku deri më 24 gusht. Piku i tij këtë vit do të jetë natën e 12 gushtit dhe mëngjesin e 13 gushtit. Gjysmëhëna nuk duhet të jetë shumë problem këtë vit. Qiejt duhet të jenë ende mjaft të errët për një shfaqje të mirë. Shikimi më i mirë do të jetë

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit gusht 2023

Table with 7 columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë. It lists various climate indicators such as temperature, precipitation, and UV index for the month of August in different regions.

nga një vend i errët pas mesnate. Meteorët do të rrezatojnë nga konstelacioni Perseus, por mund të shfaqen kudo në qiell.

Më 16 gusht - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 11:38 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objektet të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

Më 27 gusht - Saturni në opozitë. Planeti i rrethuar do të jetë në afrimin më të afërt me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli. Do të jetë më e ndritshme se çdo kohë tjetër të vitit dhe do të jetë e dukshme gjatë gjithë natës. Kjo është koha më e mirë për të parë dhe fotografuar Saturnin dhe hënën e tij. Një teleskop i mesëm ose më i madh do t'ju lejojë të shihni unazat e Saturnit dhe disa nga

hënën e tij më të ndritshme.

Më 31 gusht - Hëna e plotë, Superhëna, Hëna blu. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 03:35 UTC. Kjo është gjithashtu e treta nga katër superhënat për vitin 2023. Hëna do të jetë afërdimit të saj më të afërt me Tokën dhe mund të duket pak më e madhe dhe më e ndritshme se zakonisht. Meqenëse kjo është hëna e dytë e plotë në të njëjtin muaj, ajo nganjëherë quhet hënë blu.

Parashikimi i motit për muajin Gusht 2023

Moti në Shqipëri në gusht do të jetë i nxehtë. Temperaturat mesatare do të jenë ndërmyjet 19°C dhe 32°C. Zakonisht ditët e gushtit janë të nxehta ndërsa netët janë pak më të freskëta. Tirana në gusht do të përjetojë ditë me diell dhe

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin gusht 2023

Table with 13 columns: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %, Dita), and Shënjat Astrologjike. It provides astrological information for each day of August 2023.

shumë të ngrohta me qiell paksa të vranët. Zakonisht temperatura do të luhetet rreth 32°C dhe do të ndihet për 38°C, era do të jetë fllad i lehtë. Gushti në Tiranë do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Kur udhëtoni për në Tiranë në gusht mund të prisni: herë pas here reshje shiu, herë pas here stuhi, herë pas here mjegull dhe mot tropikal. Zakonisht java e tretë do të jetë më e nxehta në gusht,por mund të ketë dhe stuhi. Ngjarjet e motit që mund të ndodhin në Tiranë: 2 herë Shi, 3 herë Bubullima (Stuhi),

më pak se 1 herë Mjegull. Temperaturat e larta ditore do të ulen me 2°C, nga 32°C në 30°C, rrallë duke rënë nën 25°C ose duke kaluar 36°C. Temperatura më e lartë mesatare ditore do të jetë 32°C më 6 gusht. Temperaturat e ulëta ditore do të ulen me 2°C, nga 18°C në 16°C, rrallë duke rënë nën 12°C ose duke kaluar 21°C.

Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18°C në 32°C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga 0°C në 11°C.

shumë të ngrohta me qiell paksa të vranët. Zakonisht temperatura do të luhetet rreth 32°C dhe do të ndihet për 38°C, era do të jetë fllad i lehtë. Gushti në Tiranë do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Kur udhëtoni për në Tiranë në gusht mund të prisni: herë pas here reshje shiu, herë pas here stuhi, herë pas here mjegull dhe mot tropikal. Zakonisht java e tretë do të jetë më e nxehta në gusht,por mund të ketë dhe stuhi. Ngjarjet e motit që mund të ndodhin në Tiranë: 2 herë Shi, 3 herë Bubullima (Stuhi),

më pak se 1 herë Mjegull. Temperaturat e larta ditore do të ulen me 2°C, nga 32°C në 30°C, rrallë duke rënë nën 25°C ose duke kaluar 36°C. Temperatura më e lartë mesatare ditore do të jetë 32°C më 6 gusht. Temperaturat e ulëta ditore do të ulen me 2°C, nga 18°C në 16°C, rrallë duke rënë nën 12°C ose duke kaluar 21°C.

vranësira ose kryesisht vranësira do të rritet nga 10% në 20%. Dita më e kthjellët e muajit do të jetë 1 gushti, me kushte të kthjellëta, kryesisht të kthjellëta ose pjesërisht të vranësira në 90% të rasteve. Gjatë gushtit mbulimi mesatar i qiellit me re do të jetë 16%.

Për referencë, më 7 dhjetor, dita më e vrenjtur e vitit, shansi i kushteve të mbuluara me re ose më së shumti me re është 55%, ndërsa më 21 korrik, dita më e qartë e vitit, (Vijon në faqen 14)

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

